

MENDIMI MOSPAJTUES I GJYQTARES VALDETE DAKA ne çeshtjen penale
PML.nr. Kzz.nr.98/2016

Me 10 maj 2016 ne Panelin e perbere nga gjyqtaret e EULEX-it te Gjykates Supreme kemi shqyrtuar çeshtjen penale PML.nr.Kzz.nr.98/2016 lidhur me kerkesen per mbrojtjen e ligjshmerise te ushtruar nga mbrojtjesi i te denuarit Hysni **HT** Shoqeria e Avokateve Sejdiu dhe Qerkini te ushtruar kunder aktvendimit te Gjykates se apelit Pn.nr.162/2016 te dates 9 mars 2016. Une shfaqi mendimin mspajtues me anetaret e tjere te Kolegjit lidhur me lejueshmerine e ushtrimit te kerkeses per mbrojtjen e ligjshmerise kunder aktvendimit te Gjykates se Apelit me te cilin vendimi i gjyqtarit e Kryetarit te Gjykates Themelore te Mitrovices me te cilen eshte urdheruar transferimin i te denuarit **HT** nga QKUK ne Prishtine ne Burgun e Sigurise se Larte ne Podujeve.

Ne kete çeshtje penale, i denuari **HT** eshte shpa/le fajtor per krimet e luftes me aktgjykimin e Gjykates Themelore te Mitrovices P.nr.58/2014 date 27 maj 2015 dhe eshte gjykuar me denim me burgim unik ne kohezgjatje prej 7 (shtate) vitesh, vendim ky i cili eshte ne fazen e apelimit dhe pritet vendimi i Gjykates se Apelit te Kosoves, lidhur me ankesen e parashtruar kunder ketij aktgjykimi.

I denuari gjate qendrimit te tij ne paraburgim ne Qendren e paraburgimit ne Dubrave, me kerkesa te tij, me leje te Gjykates Themelore te Mitrovices eshte ushtruar ne Kliniken e semundjeve infektive te QKUK per shkak te problemeve shendetesore me date 23 shtator 2015 ndersa me 7 dhjetor 2015 i njejti eshte verejtur duke u larguar nga Klinika pa shoqerimin e officereve, ndersa me 16 dhjetor 2015 nga nje mjek nderkombetar eshte kryer nje kontro/mjekesore i tij dhe eshte konstatuar se nuk yuan nga asnje semundje dhe nuk ka pasur arsyemjekesore per te vazduar qendrimin e tij ne spital. Me date 18 shkurt 2016 , Kryetari i Gjykates Themelore te Mitrovices urdheroi qe i denuari te transferohet menjehere nga QKUK ne Burgun e sigurise se Larte ne Podujeve ndersa me 9 mars 2016 Gjykata e Apelit e refuzoi ankesen kunder ketij urdhri.

Kunder vendimit te Gjykates se apelit, kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise ka paraqitur mbrojtjesi i te denuarit Shoqeria e Avokateve Sejdiu dhe Qerkini me pretendim se jane shkele dispozitat relevante te Kodit te procedures penale dhe Ligji per ekzekutimin e sanksioneve penale,pa u cekur cilal.

Prokurori i Shtetit te Kosoves, me shkresen KMLP./l.nr.ZZZK./l.nr.68/2016 date 12.4.2016 ka propozuar qe kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise te hidhet poshte si e palejueshme meqenese me dispozitat e KPPK-se jane vendosur

rregullat e qarta se kur nje vendim gjyqesor mund te kundershtohet permes nje kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise.

Une e bazoj mendimin tim ne faktet e meposhtme.

Ne nenin 432 te KPPK ne par. 1 theksohet kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise mund te paraqitet kunder vendimit gjyqesor te formes se prere ose kunder procedures gjyqesore e cila i ka paraprire marrjes se vendimit te tille pas perfundimit te procedures penale ne formen e prere, dhe ne par. 4 theksohet se kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise pavaresisht nga dispozita e par. 1 mund te paraqitet gjate procedures penale e cila nuk ka perfunduar ne forme te prere vetem kunder vendimeve te formes se prere lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.

Nga kjo dispozite ligjore rezulton se mundesa qe te behet kerkesa per mbrojtje ligjore kunder vendimeve te cilat nuk jane te formes se prere apo kunder vendimeve qe nuk kane te bejne me caktimin apo vazhdimin e paraburgimit eshte e pamundur.

Aq me teper, ne kerkesen per mbrojtjen e ligjshmerise nuk potencohen fare se cilat jane shkeljet e Kodit te Procedures penale apo te Ligjit penal, sepse nga vet dispozita e nenit 432 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 te KPPK-se, percakton se per cilat arsyet mund te paraqitet kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise dhe ne rastin konkret ne kerkesa fare nuk jane cekur dispozitat te cilat pretendohet se jane shkele.

Interpretimi i gjyqtareve te cilet kishin mendim te kundert se kjo <;eshtje ka te beje me te drejtat dhe lirite themelore te nje individi, fare nuk qendron sepse edhe me Konventen Evropiane per Mbrojtjen e Lirive dhe te Drejtave te Njeriut, eshte parapare qe ndaj <;do vendimi gjyqesor duhet te kete dy shkalleshmeri dhe ne rastin konkret nga shkresat e <;eshtjes vertetohet se te denuarit i eshte dhene mundesa e ankimimit te vendimit te gjykates se shkalles se pare, prandaj edhe keto dispozita jane respektuar.

Nga te gjitha keto qe u tha me larte, konsideroj se kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise, e ushtruar duhet te hidhet si e palejuar e konform dispozites se nenit 434 par. 2 pika 2.1 te KPPKS-se.